



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LENDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

**TITULLI I LËNDËS: HISTORIA E SHQIPËRISË 3: RILINDJA DHE PAVARËSIA
(1830-1939)**

Pedagogu: Prof. Asoc. Dr. Artan Puto
Ngarkesa: 6 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: III/I

EKSTRAKT

Lënda e ‘Histori e Shqipërisë », periudha e Rilindjes (1830-1912) dhe ajo e Pavarësisë (1912-1939) synon t’u japë studentëve te drejtimit Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore njohutri bazë mbi momentet me kryesore të ketyre dy periudhave historike te rëndësishme te vendit. Periudha e parë, ajo e Rilindjes hedh bazat e një levizje kombëtare ne mesin e shqiptarëve e cila kulmon me pavarësinë e Shqipërisë. Periudha e dytë, ajo e Pavarësisë ka të bëjë me sfida të rëndësishme si ngritja dhe konsolidimi i shtetit shqiptar dalja e tij në arenën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe përballja me interesat e fuqive, si Italia fashiste dhe Jugosllavia. Leksionet do të bazohen ne njohuri të përgjithshme, por nje vëmendje e veçantë do t’i japet edhe interpretimeve të ndryshme historike mbi ngjarjet që përfshihen në këtë hark kohor. Kjo metodologji kërkon të zhvillojë te studentët aftësinë për të gjykuar në mënyrë të pavarur.

TEMAT:

LEKSION 1. Rilindja Kombëtare shqiptare. Reformat e Tanzimatit dhe shqiptarët (1840-1850)

LEKSION 2. Mendimi politik dhe kultura kombëtare në vitet 1850-1870.

LEKSION 3. Kriza Lindore dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 70 të shek. XIX. Çështja shqiptare në arenën ndërkombëtare. Traktati i Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit 1878.

LEKSION 4. Themelimi i Lidhjes së Prizrenit (1878). Mbrojtja e viseve shqiptare. Përpjekjet për realizimin e autonomisë në vitet (1878-1881).

LEKSION 5. Lidhja e Pejës (1899-1900). Programi politik i Sami Frashëri në veprën « Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet » (1899).

LEKSION 6. Revolucioni xhonturk 1908 dhe shqiptarët. Kongreset e Manastirit, Dibërës dhe Elbasanit (1908-1909). Kryengritjet shqiptare 1910-1912.

LEKSION 7. Rrethanat që çuan në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë (1912).

LEKSION 8. Interesat e Austro-Hungarisë dhe Italisë në çështjen shqiptare në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX.

LEKSION 9. Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe përcaktimi i fatit të Shqipërisë në të (1912-1913). Vilhelm Vidi dhe mbretërimi i tij në Shqipëri (1914).

LEKSION 10. Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918). Konferenca e Paqes në Paris (1919-1920).

LEKSION 11. Ndërtimi dhe organizimi i shtetit shqiptar në vitet 1920-1924. Marrëdhëniet ndërkombëtare në vitet 1920-1924.

LEKSION 12. Zhvillimet politiko-shoqërore gjatë Republikës shqiptare (1925-1928). Marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit shqiptar gjatë Republikës (1925-1928).

LEKSION 13. Mbretëria shqiptare dhe stabilizimi i shtetit shqiptar (1928-1939). Marrëdhëniet e shtetit shqiptar gjatë Monarkisë (1928-1939).

LEKSION 14. Mendimi politiko-shoqëror 1925-1939. Lëvizjet social-politike në Shqipëri 1925-1939.

LEKSION 15. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste (1939).

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

Historia e Popullit Shqiptar, vëll.2, Shtëpia Botuese « Toena », Tiranë 2002

Stavro Skëndi, « Zgjimi kombëtar shqiptar », Shtëpia Botuese « Phoenix », Tiranë 2000

Nuray Bozborra, « Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane », Shtëpia Botuese « Dituria », Tiranë 2002

Nathalie Clayer, « Në fillimet e nacionalizmit shqiptar », Botime « Përpyjekja », Tiranë 2012

Arben Puto, « Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926 », Shtëpia Botuese « Dudaj », Tiranë 2010

Valentina Duka, « Histori e Shqipërisë 1912-2000 », Botime Universitare « Albas », Tiranë 2014

Arben Puto, « Shqipëria politike 1912-1939 », Shtëpia Botuese « Toena », Tiranë 2009